# FLETORJA ZYRTARE
# E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**

**www.qpz.gov.al**

**Nr. 119 — 13 shtator — 2012**


PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i KM nr. 518, 16.8.2012 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 1619, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore" ............................................ | 6765 |
| Vendim i KM nr. 519, datë 16.8.2012 | Për rishpërndarje fondesh brenda programeve, në buxhetin e vitit 2012, të miratuara për Ministrinë e Drejtësisë............ | 6769 |
| Vendim i KM nr. 525, datë 16.8.2012 | Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive e të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Europian, në kuadër të instrumentit të parazgjerimit (IPA), Komponenti II - "Bashkëpunimi ndërkufitar".................. | 6770 |
| Vendim i KM nr. 527, datë 16.8.2012 | Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e Forcave të Armatosura" ...................................................... | 6777 |
| Vendim i KM nr. 529, datë 1.8.2012 | Për dhënien në përdorim, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të disa mjediseve të ndërtesës së Prefekturës Elbasan............................................... | 6796 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i KM nr. 591, datë 1.8.2012 | Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për zhvillimin e një projekti koncesionar në zonat plazh Dhërmi dhe plazh Perivoll, me karakter turistik, panoramik dhe informues, ndërtimin e infrastrukturës përkatëse dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë “Eurokontakt”, sh.p.k.......................... | 6798 |

# VENDIM
## Nr. 518, datë 16.8.2012

## PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1619, DATË 2.7.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE, GRUPIMIN E NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE PËR EFEKT PAGE DHE CAKTIMIN E KUFIJVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", dhe të neneve 24, 32 e 54 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1619, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
a) Shkronjat "a" deri në "e" të pikës 1 të vendimit, ndryshohen si më poshtë vijon:
"a) Për Bashkinë e Tiranës:
- Kryetari 140 000 - 174 760 lekë;
- Nënkryetari 130 000 - 140 000 lekë.
b) Për njësitë e qeverisjes vendore me mbi 100 000 banorë:
- Kryetari 92 000 - 140 000 lekë;
- Nënkryetari 60 000 - 93 000 lekë.
c) Për njësitë e qeverisjes vendore me 50 001-100 000 banorë:
- Kryetari 60 000 - 116 000 lekë;
- Nënkryetari 49 000 - 91 000 lekë.
ç) Për njësitë e qeverisjes vendore me 20 001-50 000 banorë:
- Kryetari 51 000 - 91 000 lekë;
- Nënkryetari 41 000 - 78 000 lekë.
d) Për njësitë e qeverisjes vendore me 5 001-20 000 banorë:
- Kryetari 41 000 - 78 000 lekë;
- Nënkryetari 28 000 - 69 000 lekë.
dh) Për njësitë e qeverisjes vendore me nën 5 000 banorë:
- Kryetari 37 000 - 55 000 lekë;
- Nënkryetari 27 000 - 43 000 lekë
e) Për Këshillin e Qarkut:
- Kryetari 87 000 - 132 000 lekë;
- Nënkryetari 57 000 - 91 000 lekë.".

b) Lidhja nr. 1 "Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë të Bashkisë së Tiranës", që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Lidhja nr. 2 "Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë në bashkitë e tjera, njësitë bashkiake të Tiranës dhe për nëpunësit e komunave", që përmendet në pikën 3, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ç) Lidhja nr. 3 "Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë të Këshillit të Qarkut", që përmendet në pikën 4, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

d) Lidhja nr. 6 "Vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar", që përmendet në pikën 5, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

dh) Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"9. "Specialistët", "përgjegjësit e sektorit" apo "drejtorët e drejtorive" të njësive të qeverisjes vendore, të cilët punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së institucioneve të tyre dhe kërkojnë në mënyrë të detyrueshme diplomë universitare "Master i shkencave" apo të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët "Inxhinieri elektronike" apo "Informatikë", përfitojnë një shtesë "për kushte pune", prej 10 000 lekësh, mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse. Miratimi i kësaj shtese për pozicionet konkrete do të bëhet, rast pas rasti, nga drejtoritë/njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore, në njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përshkrimin e pozicionit të punës.".

e) Lidhja nr. 5 "Struktura dhe kufijtë e pagave për punonjësit e policisë të bashkive e të komunave", që përmendet në pikën 13, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ë) Në pikën 18, vlera "… 32 000 lekë në muaj …" bëhet "… 33 000 lekë në muaj …".

f) Në pikën 19, vlera "… nga 20 000 deri në 32 000 lekë në muaj …" bëhet "… nga 21 000 deri në 33 000 lekë në muaj …".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2012, të përballohen nga të ardhurat e vetë njësive të qeverisjes vendore, për vitin 2012.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2012.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**LIDHJA NR. 1**

**Nivelet e pagave për nëpunësit civilë në Bashkinë e Tiranës**

| | | **Paga mujore (lekë)** | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Klasa** | **Kategoritë** | **Paga individuale** | | | **Shtesa e pozicionit** |
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| | | Paga e grupit | Shtesa për vjetërsi | Shtesa për kualifikim | Shtesa për pozicion |
| I | I-b | 1 | 2% | 0 | Nga 69.000 deri 117.500 |
| II | II-a | 1 | 2% | 0 | Nga 66.000 deri 107.300 |
| | II-b | 1 | 2% | 0 | Nga 58.000 deri 90.200 |
| III | III-a | 1 | 2% | 0 | Nga 32.000 deri 72.900 |
| | III-a/1 | 1 | 2% | 0 | Nga 29.000 deri 63.700 |
| | III-b | 1 ose 2 | 2% | 0 | Nga 27.000 deri 55.500 |
| IV | IV-a | 1 ose 2 ose 3 | 2% | 0 | Nga 25.000 deri 44.300 |
| | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 2% | 0 | Nga 23.000 deri 34.200 |

**LIDHJA NR 2**

**Nivelet e pagave për nëpunësit civilë në bashkitë e tjera, njësitë bashkiake të Tiranës dhe nëpunësit e komunave**

| KLASA | KATEGORITË | PAGA INDIVIDUALE | | PAGA MUJORE (LEKE) SHTESA E POZICIONIT | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Njësi të qeverisjes vendore me mbi 100000 banorë | Njësi të qeverisjes vendore me 50001-100000 banorë | Njësi të qeverisjes vendore me 20001-50000 banorë | Njësi të qeverisjes vendore me 5001-20000 banorë | Njësi të qeverisjes vendore me me pak se 5000 banorë |
| | *1* | | 2 | *4* | 5 | *6* | *7* | *8* |
| | | Paga e grupit | Shtesa për vjetërsi në punë | Shtesa për pozicion | Shtesa për pozicion | Shtesa për pozicion | Shtesa për pozicion | Shtesa për pozicion |
| I | I-b | 1 | 2% | Nga 25.000 deri 68.700 | Nga 22.200 deri 61.985 | Nga 20.600 deri 50.440 | Nga 19.600 deri 35.190 | Nga 17.000 deri 29.480 |
| II | II-a | 1 | 2% | Nga 24.000 deri 65.130 | - | - | - | - |
| | II-b | 1 | 2% | Nga 20.600 deri 55.490 | Nga 19.600 deri 50.440 | Nga 17.000 deri 40.500 | Nga 16.500 deri 34.700 | Nga 16.000 deri 26.630 |
| III | III-a/1 | 1 | 2% | Nga 20.000 deri 49.370 | Nga 18.600 deri 44.200 | Nga 16.700 deri 38.360 | Nga 15.500 deri 31.000 | Nga 15.000 deri 25.800 |
| | III-b | 1 ose 2 | 2% | Nga 19.600 deri 44.990 | Nga 17.000 deri 41.500 | Nga 16.300 deri 36.210 | Nga 15.000 deri 28.870 | Nga 14.000 deri 25.250 |
| IV | IV-a | 1 ose 2 ose 3 | 2% | Nga 13.000 deri 32.130 | Nga 13.000 deri 29.990 | Nga 12.000 deri 28.900 | Nga 12.000 deri 27.340 | Nga 12.000 deri 21.630 |
| | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 2% | Nga 12.000 deri 29.500 | Nga 11.500 deri 26.270 | Nga 11.500 deri 22.100 | Nga 11.000 deri 21.500 | Nga 11.000 deri 21.000 |

**Shenim:** Këshilli i bashkisë dhe komunës në përcaktimin e shtesës në pagë për pozicion, sipas ndarjes në njësi vendore, bazohet në numrin e banorëve të Regjistrit të Gjendjes Civile, në fillim të vitit kalendarik.

**LIDHJA NR. 3**

**Nivelet e pagave për nëpunësit civilë në Këshillin e Qarkut**

| | | Paga mujore (lekë) | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Klasa** | **Kategoritë** | **Paga individuale** | | | **Shtesa e pozicionit** |
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| | | Paga e grupit | Shtesa për vjetërsi | Shtesa për kualifikim | Shtesa për pozicion |
| I | I-b | 1 | 2% | 0 | Nga 36.000 deri 75.350 |
| II | II-a | - | - | 0 | - |
| | II-b | 1 | 2% | 0 | Nga 23.500 deri 57.270 |
| III | III-a/1 | 1 | 2% | 0 | Nga 23.500 deri 49.860 |
| | III-b | 1 ose 2 | 2% | 0 | Nga 19.000 deri 45.630 |
| IV | IV-a | 1 ose 2 ose 3 | 2% | 0 | Nga 13.000 deri 35.020 |
| | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 2% | 0 | Nga 12.500 deri 22.270 |

**LIDHJA NR. 5**

**Struktura dhe kufijtë e pagave për punonjësit e policisë së bashkive e të komunave**

| | Paga (lekë/muaj) | |
|---|---|---|
| **Emërtesa** | **Nga** | **Deri** |
| Kryeinspektor i Policisë Bashkiake të Tiranës | 74900 | 85350 |
| Kryeinspektor i Policisë në njësitë e qeverisjes vendore me mbi 50 000 banorë | 59310 | 67650 |
| Kryeinspektor i Policisë në njësitë qeverisjes vendore, nga 5001 deri në 50 000 banorë | 45780 | 51000 |
| Inspektor i Policisë Bashkiake të Tiranës | 59310 | 67650 |
| Inspektor i Policisë në njësitë e qeverisjes vendore me mbi 50 000 banorë | 41620 | 46850 |
| Inspektor i Policisë në njësitë qeverisjes vendore, nga 5001 deri në 50 000 banorë | 35380 | 40600 |
| Punonjës i Policisë Bashkiake të Tiranës | 45780 | 51000 |
| Punonjës i Policisë në njësitë e qeverisjes vendore, me mbi 50000 banorë | 35380 | 40600 |
| Punonjës i Policisë në njësitë e qeverisjes vendore, nga 5001 deri në 50000 banorë | 33300 | 38500 |
| Punonjës i Policisë në njësitë e qeverisjes vendore, deri në 5001 banorë | 30180 | 33300 |

**LIDHJA NR. 6**

**Vlerat e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar**

| Grupi i diplomës | Lloji i diplomës | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | Master i shkencave<br>Master i arteve<br>Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 14000 lekë |
| 2 | Master profesional<br>Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 11000 lekë |
| 3 | *Bachelor*<br>Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 10000 lekë |

**VENDIM**
**Nr. 519, datë 16.8.2012**

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BRENDA PROGRAMEVE, NË BUXHETIN E VITIT 2012, TË MIRATUARA PËR MINISTRINË E DREJTËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "a" të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 17 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve brenda programeve, në buxhetin e vitit 2012, të miratuara për Ministrinë e Drejtësisë, zëri "Shpenzime korente", si më poshtë vijon:

a) Programit të planifikimit, menaxhimit dhe administrimit, për vitin 2012, në shpenzimet e personelit, i pakësohet fondi prej 1 800 000 (një milion e tetëqind mijë) lekësh;

b) Programit të sistemit të burgjeve, për vitin 2012, në shpenzimet e personelit, i pakësohet fondi prej 23 000 000 (njëzet e tre milionë) lekësh;

c) Programit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për vitin 2012, i pakësohet fondi për shpenzime personeli, në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë;

ç) Programit të Qendrës së Publikimeve Zyrtare, për vitin 2012, i pakësohet fondi prej 600 000 (gjashtëqind mijë) lekësh, për shpenzime personeli;

d) Programit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor, për vitin 2012, i shtohet fondi në masën 10 400 000 (dhjetë milionë e katërqind mijë) lekë për shpenzime personeli;

dh) Programit të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, për vitin 2012, në shpenzimet e personelit, i shtohet fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

# VENDIM
## Nr. 525, datë 16.8.2012

## PËR PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE, TË PËRGJEGJËSIVE E TË MARRËDHËNIEVE NDËRMJET AUTORITETEVE DHE STRUKTURAVE TË MENAXHIMIT TË DECENTRALIZUAR TË ASISTENCËS SË BASHKIMIT EUROPIAN, NË KUADËR TË INSTRUMENTIT TË PARAZGJERIMIT (IPA), KOMPONENTI II - "BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR"[1]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 dhe 8 të ligjit nr. 9840, datë 10.12.2007 "Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, për rregullat e bashkëpunimit financiar për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qëllimi
Ky vendim përcakton funksionet, përgjegjësitë dhe marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit të decentralizuar (MD) të asistencës së Bashkimit Europian, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Parazgjerimit (IPA), komponenti II - "Bashkëpunimi ndërkufitar", siç përcaktohet në nenin 85 të rregullores implementuese të IPA-së.
2. Autoritetet dhe strukturat për komponentin II të IPA-së
a) Autoritetet për menaxhimin e komponentit II të IPA-së do të jenë:
i) Koordinatori kombëtar i IPA-së (KKIPA/NIPAC);
ii) Zyrtari përgjegjës akreditues (ZPA/CAO);
iii) Zyrtari kombëtar autorizues (ZKA/NAO);
iv) Zyrtari autorizues i programit (ZAP/PAO);
v) Drejtuesi i Strukturës Operative (DSO/HOS);
b) Strukturat për menaxhimin e komponentit II të IPA-së do të jenë:
i) Struktura operative (SO/OS), e cila përbëhet nga dy njësi:
- Njësia e Bashkëpunimit Ndërkufitar,
- Agjencia implementuese (AI);
ii) Fondi Kombëtar;
iii) Zyra e ZKA/NAO-së;
iv) Autoriteti i auditit.
3. Koordinatori kombëtar i IPA-së (KKIPA/NIPAC)
a) Koordinatori kombëtar i IPA-së (KKIPA/ NIPAC) është ministri përgjegjës për integrimin.
b) Në përputhje me pikën 2 të aneksit A të marrëveshjes kuadër, ratifikuar me ligjin nr. 9840, datë 10.12.2007, koordinatori kombëtar i IPA-së (KKIPA/NIPAC) është përgjegjës për:
i) të siguruar koordinimin e përgjithshëm të asistencës IPA;
ii) koordinimin e procesit të programimit për komponentin II të IPA-së për palën shqiptare;
iii) koordinimin e pjesëmarrjes së Shqipërisë në programet përkatëse të bashkëpunimit ndërkufitar me shtetet anëtare të BE-së dhe me vendet e tjera përfituese, si dhe në programet transnacionale, ndërrajonale ose detare, në kuadër të instrumenteve të tjera të Komunitetit;

[1] Në përputhje me EU acquis, ID celex – 32007R0718, Commission Regulation (EC), No 718/2007, of 12 June 2007, implementing Council Regulation (EC), No 1085/2006, establishing an instrument for pre-accession assistance (IPA).

iv) sigurimin e partneritetit ndërmjet Komisionit Europian dhe Republikës së Shqipërisë, si dhe për të siguruar që fondet e IPA-së përdoren në mënyrë efektive për zbatimin e përparësive në kuadër të integrimit europian;

v) hartimin dhe, pas kontrollit/ekzaminimit nga Komiteti i Monitorimit të IPA-së, paraqitjen e raporteve vjetore e finale mbi IPA-në, për zbatimin e asistencës së IPA-së te Komisioni Europian. Një kopje e raporteve i dërgohet ZKA-së;

vi) zbatimin e dispozitave të "Manualit të brendshëm të procedurave", miratuar prej tij, gjatë kryerjes së funksioneve të listuara në këtë vendim.

4. Zyrtari përgjegjës akreditues (ZPA/CAO)

a) Zyrtari përgjegjës akreditues (ZPA/CAO) është Ministri i Financave.

b) ZPA/CAO-ja është autoritet i menaxhimit të decentralizuar, i cili akrediton ZKA/NAO-në dhe strukturën e tij mbështetëse (zyrën e ZKA/NAO-së dhe Fondin Kombëtar) për menaxhimin e decentralizuar të komponentëve të IPA-së, bazuar në kërkesat e përshkruara në pikën 1 të aneksit A të marrëveshjes kuadër.

c) ZPA/CAO-ja, nëpërmjet auditimeve të pavarura, kontrollon përmbushjen e kritereve të akreditimit nga ZKA/NAO-ja, zyra e ZKA/NAO-së dhe nga Fondi Kombëtar, në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 1 shkronja "c" të aneksit A të marrëveshjes kuadër.

ç) ZPA/CAO-ja njofton Komisionin Europian për akreditimin e ZKA/NAO-së, zyrës së ZKA/NAO-së dhe Fondit Kombëtar, dhe informon Komisionin Europian për çdo ndryshim në lidhje me akreditimin. Këtu përfshihet dhënia e të gjithë informacionit përkatës mbështetës që kërkohet nga Komisioni Europian.

d) Pas akreditimit të ZKA/NAO-së, zyrës së ZKA/NAO-së dhe Fondit Kombëtar, ZPA/CAO-ja është përgjegjës për monitorimin, pezullimin apo tërheqjen e akreditimit të ZKA/NAO-së, zyrës së ZKA/NAO-së dhe Fondit Kombëtar, duke informuar për këtë Komisionin Europian, bazuar në pikën 1 shkronja "b" të aneksit A të marrëveshjes kuadër.

dh) ZPA/CAO-ja organizon mbledhje dhe këshillime të rregullta me autoritetin e auditit për të siguruar funksionimin e rregullt të menaxhimit të decentralizuar të komponentit II të IPA-së.

e) ZPA/CAO-ja miraton "Manualin e brendshëm të procedurave" që përshkruan zbatimin e funksioneve të caktuara për ZPA/CAO-në dhe konfirmon "Manualin e brendshëm të procedurave" për ZKA/NAO-në, zyrës së ZKA/NAO-së dhe Fondit Kombëtar.

5. Zyrtari kombëtar autorizues (ZKA/NAO)

a) Zyrtari kombëtar autorizues (ZKA/NAO) është një zyrtar i lartë në Ministrinë e Financave, i cili emërohet nga ZPA/CAO-ja.

b) ZKA/NAO është pika kryesore e kontaktit për informacionin financiar të dërguar ndërmjet Komisionit Europian dhe Republikës së Shqipërisë.

c) ZKA/NAO-ja mbikëqyr funksionimin e zyrës së NAO-së dhe Fondit Kombëtar.

ç) ZKA/NAO-ja drejton Fondin Kombëtar, i cili mban përgjegjësinë e plotë për menaxhimin financiar të fondeve të BE-së. Në përputhje me aneksin A, neni 4, të marrëveshjes kuadër, ZKA/NAO-ja është përgjegjës për ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve të kryera në kuadër të menaxhimit të decentralizuar.

d) ZKA/NAO-ja përdor kapacitetet e Fondit Kombëtar për të ushtruar funksionet e mëposhtme:

i) është përgjegjës për hartimin dhe dorëzimin pranë Komisionin Europian të deklaratës së vërtetimit të shpenzimeve dhe pagesave të zbatuara. ZKA/NAO-ja mban përgjegjësinë e plotë për saktësinë e zbatimit të pagesave dhe për transferimin e fondeve për strukturën përkatëse operative ose përfituesit përfundimtarë;

ii) bën rregullimet e nevojshme financiare lidhur me parregullsitë e zbuluara dhe për të siguruar kthimin e fondeve të papërdorura ose të keqpërdorura;

iii) i dorëzon Komisionit Europian një parashikim të aplikimeve të mundshme për pagesa, për vitin financiar në fjalë dhe për vitin pasardhës financiar, më 28 shkurt të çdo viti;

iv) siguron ekzistencën e bashkëfinancimit kombëtar të nevojshëm, në përputhje me marrëveshjet financiare nën instrumentin IPA, në mënyrë që të mundë të parashikohet në buxhetin vjetor të Republikës së Shqipërisë;

v) bën të mundur që sistemi i raportimit financiar të Komisionit Europian të përditësohet rregullisht dhe procedurat e raportimit të respektohen siç duhet nga Fondi Kombëtar dhe agjencia implementuese;

dh) ZKA/NAO-ja drejton zyrën e ZKA/NAO-së dhe bazuar në aneksin A neni 4 të marrëveshjes kuadër, është përgjegjëse për funksionimin efektiv të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit në përputhje me kërkesat e IPA-së për dhënien, monitorimin dhe pezullimin apo tërheqjen e akreditimit të strukturës operative;

e) ZKA/NAO-ja përdor kapacitetet e zyrës së ZKA/NAO-së për të kryer funksionet e mëposhtme:

i) mban përgjegjësinë e plotë për identifikimin, hetimin e çdo parregullsie dhe rastet e dyshuara e reale të mashtrimit dhe për informimin e Komisionit Europian për to. Në ushtrimin e këtij funksioni ZKA/NAO-ja bashkëpunon me Shërbimin e Koordinimit kundër Mashtrimit (AFCOS);

ii) është përgjegjëse për dhënien e akreditimit strukturës operative për zbatimin e IPA-së, komponenti II, dhe për vënien në dijeni të Komisionit Europian, në përputhje me nenin 11 të marrëveshjes kuadër. ZKA/NAO-ja i jep akreditimin strukturës operative pasi sigurohet, bazuar në një opinion auditi të pavarur, se kërkesat e parashikuara në nenin 9 të marrëveshjes kuadër, janë plotësuar;

iii) njofton Komisionin Europian për akreditimin e strukturës operative dhe siguron të gjithë informacionin mbështetës të kërkuar nga Komisioni Europian, përfshirë një përshkrim të sistemeve të menaxhimit dhe të kontrollit;

iv) pas akreditimit të strukturës operative, është përgjegjëse për monitorimin, pezullimin apo tërheqjen e akreditimit të strukturës operative dhe për informimin e ZPA/CAO-së e të Komisionit Europian për ndonjë ndryshim të rëndësishëm lidhur me to;

v) në rast se ndonjë nga kërkesat e kritereve të akreditimit nuk është plotësuar ose nuk ekziston më, do të pezullojë ose do të tërheqë akreditimin e strukturës operative përkatëse dhe do të njoftojë menjëherë Komisionin Europian dhe ZPA/CAO-në për vendimin dhe për arsyet e këtij vendimi. ZKA/NAO-ja sigurohet që këto kërkesa përmbushen sërish para dhënies së akreditimit përkatës. Kjo siguri duhet të mbështetet nga një opinion auditimi;

vi) në rast se zbulon dobësi në sistemin e menaxhimit dhe të kontrollit, informon drejtuesit e organeve që përbëjnë strukturën operative dhe jep rekomandime për marrjen e masave të duhura korrigjuese;

vii) ndjek gjetjet e raporteve të auditimit nga autoriteti i auditimit në mënyrë që të monitorojë me sukses funksionimin e sistemeve të menaxhimit dhe të kontrollit;

viii) kur është e nevojshme, mund të angazhojë auditues të pavarur për të kryer auditime shtesë mbi të gjitha autoritetet dhe organet e përfshira në sistemin e menaxhimit të decentralizuar të fondeve të IPA-së, me qëllim që të sigurojë funksionimin efektiv dhe efikas të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e IPA-së;

ix) dorëzon një deklaratë vjetore garancie te Komisioni Europian me një kopje, ZPA/CAO-së, në përputhje me nenin 17 të marrëveshjes kuadër. Nëse konfirmimi i funksionimit efektiv të sistemeve të menaxhimit dhe të kontrollit, si dhe konfirmimi për ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve në fjalë nuk janë të gatshme, ZKA/NAO-ja informon Komisionin Europian dhe ZPA/CAO-në për arsyet dhe pasojat e mundshme të ngjarjes së ndodhur, si dhe masat e ndërmarra korrigjuese, me qëllim kapërcimin e saj dhe mbrojtjen e interesave të Komunitetit.

ë) ZKA/NAO-ja do të nënshkruajë marrëveshjen implementuese me drejtuesin e strukturës operative (DSO/HOS) për menaxhimin e decentralizuar të IPA-së, komponenti II, programet e bashkëpunimit ndërkufitar, për kryerjen e funksioneve të tyre në bazë të këtij vendimi.

f) ZKA/NAO-ja miraton "Manualin e brendshëm të procedurave" për ZKA/NAO-në, zyrën e ZKA/NAO-së dhe Fondin Kombëtar dhe konfirmon manualin e brendshëm të procedurave të organeve që përbëjnë strukturën operative, ku përshkruhet zbatimi i funksioneve të caktuara për këtë strukturë.

6. Zyra e zyrtarit kombëtar autorizues (ZKA/NAO)

a) Zyra e zyrtarit kombëtar autorizues (ZKA/NAO) është një strukturë e krijuar në Ministrinë e Financave me qëllim të mbështesë ZKA/NAO-në në ushtrimin e funksionit të tij për monitorimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit në bazë të rregullores implementuese të IPA-së, sipas pikës 4, shkronja "b" të aneksit A të marrëveshjes kuadër.

b) Zyra e ZKA/NAO-së do të mbështesë ZKA/NAO-në në detyrat e mëposhtme:

i) marrjen, në emër të ZKA/NAO-së, të konfirmimit se struktura operative ka ngritur sisteme të menaxhimit të shëndoshë financiar e të kontrollit dhe se rregullisht ato përditësojnë informacionin përkatës;

ii) dhënien, monitorimin dhe pezullimin apo tërheqjen e akreditimit të strukturës operative;

iii) sigurimin e ekzistencës e funksionimit efektiv të sistemeve të menaxhimit të asistencës sipas rregullores implementuese të IPA-së;

iv) siguron që sistemi i kontrollit të brendshëm për menaxhimin e fondeve është efektiv dhe efikas;

v) krijimin e një sistemi për raportimin, regjistrimin, ndjekjen, kthimin e fondeve të paguara gabim dhe bashkëpunimin me Komisionin Europian për të gjitha çështjet që lidhen me parregullsitë;

vi) raportimin për sistemet e menaxhimin dhe kontrollit;

vii) sigurimin se sistemi i duhur i raportimit dhe i informacionit funksionon;

viii) ndjek gjetjet e raporteve të auditimit të autoritetit të auditit.

c) Me kërkesë të ZKA/NAO-së, zyra e ZKA/NAO-së kryen kontrolle në vend në agjencinë implementuese, si dhe në strukturat e IPA-së në ministritë e linjës/institucionet përfituese, për kontrollin dhe monitorimin më të frytshëm të projekteve të financuara nën Instrumentin IPA, si dhe për të siguruar ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve lidhur me to, në përputhje me pikën 4 të aneksit A të marrëveshjes kuadër, dhe me nenin 25 të rregullores implementuese të IPA-së, 718/2007.

ç) Gjatë kryerjes së detyrave, punonjësit e zyrës së ZKA/NAO-së do të ndjekin dispozitat e "Manualit të brendshëm të procedurave" për zyrën e ZKA/NAO-së, të miratuar nga ZKA/NAO-ja dhe të konfirmuar nga ZPA/CAO-ja.

7. Fondi Kombëtar

a) Fondi Kombëtar është organ qendror thesari në Ministrinë e Financave, njësia e vetme nëpërmjet të cilit fondet IPA të Komisionit Europian do të transferohen në Republikën e Shqipërisë sipas pikës 4 shkronja "a" dhe pikës 5 të aneksit A të marrëveshjes kuadër.

b) Fondi Kombëtar, i drejtuar nga ZKA/NAO-ja, është përgjegjës për menaxhimin financiar të fondeve IPA, në veçanti:

i) për hapjen dhe menaxhimin e llogarive bankare;

ii) për kërkimin e fondeve nga Komisioni Europian;

iii) për të asistuar ZKA/NAO-në në verifikimin se bashkëfinancimet nga buxheti kombëtar dhe burimet e tjera (kur është e përshtatshme) që janë në dispozicion mund të përdoren për bashkëfinancim, siç kërkohet në marrëveshjen financiare përkatëse;

iv) për miratimin e transferimit të fondeve të marra nga Komisioni Europian për strukturën operative;

v) për të paraqitur një propozim ZKA/NAO-së për rregullimin e shumës financiare të kërkuar në lidhje me parregullsitë e zbuluara në veprime apo programe, duke anuluar të gjithë ose një pjesë të kontributit IPA për veprimin ose programin përkatës;

vi) për dorëzimin e raporteve financiare pranë Komisionit Europian;

vii) për sigurimin e kontabilitetit të duhur për kontributin IPA, në përputhje me standardet e aplikueshme;

viii) siguron që i gjithë informacioni i nevojshëm është në dispozicion për të siguruar në çdo kohë një auditim të detajuar mjaftueshëm. Ky informacion do të përfshijë evidencë të dokumentuar të autorizimit të aplikimeve për pagesat, të kontabilitetit dhe të pagesave të realizuara nga këto aplikime, si dhe të trajtimit të huave, garancive dhe borxheve.

c) Fondi Kombëtar bashkëpunon me Bankën e Shqipërisë, ku ZKA/NAO-ja hap llogari në monedhë të huaj për transferimin e fondeve nga Komisioni Europian, për çdo komponent të IPA-së.

ç) Marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet ZKA/NAO-së, Fondit Kombëtar, agjencisë implementuese dhe Bankës së Shqipërisë do të qeverisen nga një marrëveshje e veçantë që rregullon termat dhe kushtet për funksionimin e llogarive në monedhë të huaj, të hapura pranë Bankës së Shqipërisë.

d) Gjatë kryerjes së funksioneve të listuara në këtë vendim, punonjësit e Fondit Kombëtar do të ndjekin dispozitat e "Manualit të brendshëm të procedurave" të Fondit Kombëtar, të miratuar nga ZKA/NAO-ja dhe të konfirmuar nga ZPA/CAO-ja.

8. Autoriteti i auditit

Autoriteti i auditit është njësi funksionalisht e pavarur nga të gjithë aktorët e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit dhe ushtron funksionet e tij në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1020, datë 14.10.2009 "Për krijimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës të Bashkimit Europian", të ndryshuar.

9. Struktura operative (SO/OS) për zbatimin e komponentit II të IPA-së "Bashkëpunimi ndërkufitar"

a) Një zyrtar i lartë në Ministrinë e Integrimit caktohet si drejtues i strukturës operative (DSO/HOS), me urdhër të brendshëm të KKIPA/NIPAC-së.

b) DSO/HOS-ja mban përgjegjësinë e plotë për menaxhimin dhe zbatimin e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar (BNK/CBC), përkatësisht:

i) është personi i vetëm përgjegjës për koordinimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të duhur të Njësisë së Bashkëpunimit Ndërkufitar BNK/CBC dhe agjencisë implementuese (AI);

ii) është përgjegjës para KKIPA/NIPAC-së dhe Komisionit Europian për realizimin e programimit të përshtatshëm dhe monitorimit në nivel programi;

iii) siguron auditimin e brendshëm të organeve të ndryshme përbërëse të SO/OS-së;

iv) siguron raportimin e parregullsive;

v) siguron përputhshmërinë me kërkesat e informacionit dhe publicitetit;

vi) siguron që të gjitha organet e përfshira në zbatimin e veprimeve të mbajnë një sistem të veçantë kontabiliteti ose një kodifikim të veçantë kontabiliteti.

c) Struktura operative (SO/OS) është përgjegjëse për menaxhimin dhe implementimin e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar të IPA-së, në përputhje me parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, dhe kryen funksionimin e saj në bazë të nenit 28 të rregullores implementuese të IPA-së.

ç) Struktura operative (SO/OS) përbëhet nga këto organe: Njësia e Bashkëpunimit Ndërkufitar (BNK) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve, që vepron si agjenci implementuese (AI).

d) Bazuar në funksionet e SO/OS-së, të përcaktuara në nenin 28 të rregullores implementuese të IPA-së, DSO/HOS-ja delegon një pjesë të funksioneve tek organet përbërëse të strukturës operative.

dh) Drejtori i strukturës operative DSO/HOS-ja nënshkruan marrëveshjen operacionale me ZAP/PAO-në si drejtuesin e agjencisë implementuese për menaxhimin e decentralizuar të programeve të bashkëpunimit ndërkufitar të komponentit II të IPA-së. Në këtë marrëveshje detyrat e DSO/HOS-së, njësisë së BNK/CBC, ZAP/PAO-së, AI-së, komitetit të përbashkët monitorues (KPM) dhe sekretariatit të përbashkët teknik (SPT) shtjellohen hollësisht.

e) Njësia e BNK/CBC-së përfaqësohet nga një zyrtar në drejtorinë e IPA-së në Ministrinë e Integrimit, i cili emërohet me urdhër të brendshëm të KKIPA/NIPAC-së dhe ka përgjegjësitë e mëposhtme:

i) të marrë vendime operacionale për programimin dhe monitorimin në nivel programi;

ii) të drejtojë autoritetin vendimmarrës për Shqipërinë në lidhje me funksionet e komitetit të përbashkët monitorues (KPM), të përcaktuara në nenin 142 pika 5 shkronjat "b" deri "d" dhe "g" deri "h" të rregullores implementuese të IPA-së;

iii) të sigurojë kontrollin dhe mbikëqyrjen e përshtatshme mbi sekretariatin e përbashkët teknik (SPT), duke ndihmuar SO/OS-në dhe KPM-në të kryejnë funksionet e tyre.

ë) Nën përgjegjësinë e drejtuesit të sektorit të BNK/CBC-së, njësia BNK/CBC ka funksionet e mëposhtme:

iv) të hartojë programet vjetore dhe shumëvjeçare;

v) të monitorojë zbatimin e programit dhe të udhëzojë punën e komitetit të monitorimit sektorial;

vi) të hartojë raportet implementuese sektoriale vjetore e përfundimtare dhe, pas shqyrtimit të tyre nga ana e Komitetit të Monitorimit Sektorial, t'i paraqesë ato në Komisionin Europian, te koordinatori kombëtar i IPA-së (KKIPA/NIPAC) dhe te zyrtari kombëtar autorizues (ZKA/NAO);

vii) të hartojë raportet vjetore dhe përfundimtare për zbatimin e programit ndërkufitar dhe, pas shqyrtimit të tyre nga Komiteti i Përbashkët Monitorues, t'i paraqesë ato në Komisionin Europian, te koordinatori kombëtar i IPA-së dhe te zyrtari kombëtar autorizues, në përputhje me nenin 144 të rregullores implementuese të IPA-së.

viii) të sigurojë se aktivitetet zgjidhen për financim dhe miratohen në përputhje me kriteret e miratuara nga komiteti i përbashkët monitorues (KPM);

ix) të ngrejë procedura që sigurojnë ruajtjen e të gjitha dokumenteve të kërkuara për sigurimin e auditimit të përshtatshëm;

x) të ngrejë, të mirëmbajë dhe të përditësojë sistemin e raportimit e të informacionit.

f) Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve (DPFK), në Ministrinë e Financave, e cila vepron si agjencia implementuese, drejtohet nga zyrtari autorizues i programit (ZAP/PAO). Zyrtari autorizues i programit emërohet nga zyrtari kombëtar autorizues (ZKA) pas konsultimeve me koordinatorin kombëtar të IPA-së (KKIPA) dhe është përgjegjës për:

i) marrjen e vendimeve operacionale në nivelin e transaksioneve;

ii) sigurimin e ligjshmërisë, rregullsisë dhe menaxhimin e shëndoshë financiar të zbatimit të çdo transaksioni, kryesisht të kontratave dhe pagesave, në zbatim të pikës 1 shkronja "f" të rregullores implementuese të IPA-së;

iii) marrjen e vendimeve përfundimtare për qëndrimin e Shqipërisë në Komitetin e Përbashkët Monitorues (KPM), pas konsultimit me Njësinë e Bashkëpunimit Ndërkufitar (BNK/CBC), për sa u përket shqyrtimit, miratimit dhe rishikimit të kritereve për përzgjedhjen e aktiviteteve, siç parashikohet në nenin 142 pika 5 shkronjat "b" deri "d" dhe "g" deri "h" të rregullores implementuese të IPA-së;

iv) ushtrimin e mbikëqyrjes për sistemet që përdoren nga të gjithë aktorët, veçanërisht nga Sekretariati i Përbashkët Teknik (SPT), në rolin e tyre për fillimin dhe verifikimin e transaksioneve financiare;

v) përcaktimin e modaliteteve procedurale për të siguruar mbikëqyrjen e sistemeve të lartpërmendura;

g) Agjencia implementuese (AI) ka këto funksione:

i) organizon procedurat e tenderimit dhe të dhënies së granteve, kontraktimin dhe realizimin e pagesave, si dhe rimarrjen e pagesave nga përfituesit finalë;

ii) siguron që ZKA/NAO-ja dhe Fondi Kombëtar të marrin të gjithë informacionin e nevojshëm për procedurat dhe verifikimet e realizuara për sa u përket shpenzimeve;

iii) kryen verifikime për të siguruar që shpenzimet e deklaruara janë zbatuar në përputhje me rregullat e aplikueshme; produktet ose shërbimet janë dorëzuar në përputhje me vendimet e miratuara dhe kërkesat për pagesa nga përfituesi final janë korrekte. Këto verifikime do të mbulojnë aspektet administrative, financiare, teknike dhe fizike të aktiviteteve.

iv) është përgjegjëse për verifikimin e shpenzimeve të projektit e dorëzimin e produkteve dhe shërbimeve (të quajtur "kontroll i nivelit të parë"), si dhe për lëshimin e deklaratës për vlefshmërinë e shpenzimeve, nënshkruar nga nëpunësi/t përkatës i/të emëruar në kuadër të programeve të bashkëpunimit transnacional.

10. Struktura e përbashkët monitoruese (SPM) për zbatimin e komponentit II të IPA-së "Bashkëpunimi ndërkufitar"

a) Për secilin program të bashkëpunimit ndërkufitar BNK/CBC, në të cilin Shqipëria merr pjesë, struktura operative shqiptare dhe struktura/t operative partnere që marrin pjesë në programin përkatës krijojnë një strukturë të përbashkët monitoruese (SPM), në përputhje me nenin 139 të rregullores implementuese të IPA-së.

b) SPM-ja do të mbikëqyrë zbatimin e programit përkatës të BNK/CBC-së.

c) Për secilin program të BNK/CBC-së, në të cilin Shqipëria merr pjesë, SPM-ja do të përbëhet nga dy organe: komiteti i përbashkët monitorues (KPM) dhe sekretariati i përbashkët teknik (SPT).

- Komiteti i përbashkët monitorues (KPM):

i) Komiteti i përbashkët monitorues (KPM), për programin përkatës të BNK/CBC-së, ngrihet bashkërisht nga struktura operative shqiptare dhe struktura operative partnere, që përfaqëson vendin përfitues, i cili merr pjesë në këtë program;

ii) KPM-ja përbëhet nga përfaqësues të strukturave operative, autoriteteve përgjegjëse kombëtare, rajonale dhe lokale, partnerëve socialë dhe ekonomikë, të autoriteteve kombëtare kompetente, rajonale dhe lokale, si dhe ndonjë organ tjetër i përshtatshëm që përfaqëson shoqërinë civile, në përputhje me nenet 142 pika 3 dhe 87 të rregullores implementuese të IPA-së;

iii) KPM-ja është organi vendimmarrës për programin përkatës të BNK/CBC-së;

iv) KPM-ja e programit përkatës të BNK/CBC-së, së bashku me strukturat operative, siguron cilësinë e zbatimit të programit ndërkufitar dhe kryen monitorimin e treguesve të programit përkatës, në përputhje me dispozitat e nenit 142 pika 5 të rregullores implementuese të IPA-së;

v) Detyrat e KPM-së rregullohen nga rregullorja e procedurave, e miratuar me vendim të KPM-së.

- Sekretariati i përbashkët teknik (SPT):

vi) Për secilin program ndërkufitar, struktura operative shqiptare dhe struktura operative partnere që merr pjesë në programin përkatës të BNK/CBC-së, ngrenë një sekretariat të përbashkët teknik (SPT) për të ndihmuar KPM-në dhe strukturat operative të kryejnë detyrat përkatëse, në përputhje me nenin 139 pika 4 të rregullores implementuese të IPA-së.

